

VENDIM
Nr. 11, datë 10.1.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
LENGARICA & ENERGY SHPK, PËR MIRATIMIN E VENDOSJES SË HIPOTEKËS
MBI ASETET QË DISPONON, NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK OF
ALBANIA SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pikës 1.3, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, nenet 6; 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.1.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë Lengarica & Energy sh.p.k., për miratimin e vendosjes së hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 88, datë 7.6.2017, miratoi kërkesën e shoqërisë Lengarica & Energy sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të bankave: Green For Growth Fund Southeast Europe S.A. (GGF) dhe Oesterreichische Entwicklungsbank AG (OeEB).

- Subjekti ka paraqitur kërkesën nr. 43 prot., datë 8.11.2017, dhe dokumentacionin shoqërues për vendosje të hipotekës mbi asetet e shoqërisë, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., për efekt të livrimit të një kredie për ndërtimin e HEC Lengarica.

- Shoqëria Lengarica & Energy sh.p.k. dhe banka (GGF) Green For Growth Fund Southeast Europe, kanë rënë dakord që Banka Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., të blejë kredinë e dhënë nga GGF-ja duke u bërë palë e re, në financimin e projektit për ndërtimin e HEC Lengarica.

- Aplikimi i shoqërisë Lengarica & Energy sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Lista e aseteve, për të cilat aplikuesi ka paraqitur kërkesën për miratimin e vendosjes së hipotekës nga ERE, ka në të asete, të cilat kanë qenë barrë hipotekore në favor të bankës (GGF) Green For Growth Fund Southeast Europe dhe AG (OeEB) Oesterreichische Entwicklungsbank AG.

- Aplikuesi duhet të çlirojë asetet sa më sipër nga barra e vendosur në favor të GGF-së dhe OeEB-së, referuar marrëveshjes hipotekore, lidhur në datën 27.3.2014, midis subjektit dhe bankave dhe të depozitojë në ERE vërtetimin nga hipoteka, ZRPP, jo më vonë se 45 ditë nga marrja e vendimit për fillimin e procedurës së miratimit të kërkesës së transferimit të aseteve.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me nenin 7, pika 1, germa “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 2 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Lengarica & Energy sh.p.k., për miratimin e vendosjes së hipotekës mbi asetet që disponon, në favor të Intesa Sanpaolo Bank of Albania

sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti